



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 38 datë 31.10.2019

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VKD NR. 21, DATË 01.12.2017 PËR “DHËNIEN E
AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE, RRJEDHOJË E PËRFUNDIMIT TE
PROCEDURËS SË MIRATIMIT PARAPRAK TË TRANSFERIMIT TË TË
DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE TË SIPËRMARRËSIT PLUS
COMMUNICATION SH.A TEK SIPËRMARRËSI VODAFONE ALBANIA SH.A”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 31.10.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr. 7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Për një ndryshim në VKD Nr. 21, datë 01.12.2017 për “Dhënien e Autorizimeve Individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraparak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a”.*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 75 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918/2008*);
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 44/2015*);
3. VKM nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (*VKM nr.277*);
4. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (*Rregullore nr. 30*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2395, datë 05.12.2013.

5. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore nr.7**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues i Projekt VKD;
2. Projekt Vendimi i arsyetuar;

si dhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

V Ë R E N :

1. Sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”, i është drejtuar AKEP me shkresat nr. 1449 prot. datë 20.05.2019 dhe nr. 2191 prot. datë 15.10.2019 me anë të të cilave i ka kërkuar AKEP ndryshimin e kanalit të sigurisë në brezin 900 MHz të tij, duke caktuar kanal ARFCN nr. 1003 (frekuenca 985.80 MHz i çiftuar me 930.80 MHz) si kanal sigurie mes tij dhe Telekom Albania sh.a dhe në kompensim të kanalit 1003 që del nga përdorimi, kërkon caktimin e kanalit ARFCN nr. 983 (frekuenca 881,8 MHz e çiftuar me 926,8 MHz), për përdorim nga Vodafone Albania sh.a. Kanali ARFCN nr. 983 ka shërbyer si kanal sigurie mes Vodafone Albania sh.a dhe ish-sipërmarrësit Plus Communications sh.a, por pas ndarjes së brezit të ketij të fundit, ky kanal sigurie ndodhet mes dy brezave të Vodafone Albania sh.a. Kalimi i kanalit ARFCN nr. 1003 të Vodafone Albania sh.a si kanal sigurie me Telekom Albania sh.a, do të garantonte përdorim eficient të spektrit 900 MHz nga dy kompanitë dhe do të shmangte interferencat mes tyre.
2. Me anë të Vendimeve Nr. 21 dhe 22, date 01.12.2017, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimeve Individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a, respektivisht tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a (VKD nr. 21) dhe sipërmarrësi Telekom Albania sh.a (VKD nr. 22), në sasi spektri të barabartë mes këtyre dy sipërmarrësve.
3. Pas ndarjes së spektrit 900 MHz të ish-sipërmarrësit Plus Communications, midis sipërmarrësve Vodafone Albania dhe Telekom Albania, midis brezave 900 MHz të këtyre sipërmarrësve nuk ka kanal mbrojtës sigurie.
4. Si pasojë e kësaj ndarje të brezit 900 MHz, mes spektrit që dispononte Vodafone Albania sh.a dhe spektrit që ka marrë nga ish-sipërmarrësi Plus Communications sh.a, ekziston një kanal sigurie, tashmë i ndodhur midis brezit të vetë Vodafone Albania, duke bërë që spektri 900 MHz i tij të mos jetë i vijueshem. Ky kanal sigurie me ARFCN nr. 983, nuk përdoret nga Vodafone Albania sh.a.
5. Me shkresën nr. 2191 prot. datë 17.10.2019, AKEP ka kërkuar qëndrimin e Telekom Albania sh.a për kërkesën e Vodafone Albania sh.a, ku kanali ARFCN nr. 1003 i Vodafone Albania sh.a, fqinj me kanalin ARFCN nr. 1004 të Telekom Albania sh.a, të kalojë si kanal sigurie mes Vodafone Albania dhe Telekom Albania sh.a.
6. Me shkresën nr. 2191/1 prot. datë 25.10.2019, Telekom Albania sh.a ka konfirmuar dakortësinë e tij për vendosjen e kanalit të sigurisë me Vodafone Albania sh.a në brezin 900 MHz.

7. Ndryshimi i kanalit të sigurisë nuk shoqërohet me efekte financiare, pasi nuk ndryshon numri i kanaleve të frekuencave të Vodafone Albania sh.a, pra nuk ndryshon sasia totale e spektrit të brezit 900 MHz të alokuar sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë:

1. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 21 datë 01.12.2017 për “Dhënien e Autorizimeve Individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a”.
2. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 22 datë 01.12.2017 për “Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek sipërmarrësi Telekom Albania sh.a”.
3. Garantimin e përdorimit eficient të spektrit 900 MHz dhe shmangien e interferencave mes Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a,

Në mbështetje të nenit 114 të Ligjit nr.9918/2008 si dhe Rregullores nr.7 “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike” e ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e Aneksit 2 të VKD Nr. 21, datë 01.12.2017 për “Dhënien e Autorizimeve Individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi dhe dërgimin e tij sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, si dhe njoftimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a për këtë vendim.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Ilir ZELA

Ketrin TOPÇIU

Edlira DVORANI